REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 70/17
Datë/Datum 24.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova –Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	70/17
PËR:	- Zyrtarit e prokurimit të AK-së- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a. - Parashtruesit të ankesës **"ER-LIS SH.P.K.&VE-MOR SH.P.K."** me seli në Pejë
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrije Bullatovci, Ekspert shqyrtues i prokurimit Bullatovci
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar **"ER-LIS SH.P.K.&VE-MOR SH.P.K."** me seli në Pejë, me numër protokollit 70/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave gypave të kracerit"**, me nr. të prokurimit KEKO/16/145/221, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a..

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	24.03.2017
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave gypave të kracerit"**, me nr. të prokurimit KEKO/16/145/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a., si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues **"ER-LIS SH.P.K.&VE-MOR SH.P.K."** me seli në Pejë, me numër protokollit 70/17.

Konform nenit *113 dhe 114*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bujadori		14.03.2017		15.03.2017		24.03.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë 10 shkurt 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE **"ER-LIS SH.P.K.&VE-MOR SH.P.K."** me seli në Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave gypave të kracerit"**, me nr. të prokurimit KEKO/16/145/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a.
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: "ER-LIS SH.P.K.&VE-MOR SH.P.K." me seli në Pejë

Pikat e Ankesës:

- Shkelje e nenit 1, Qëllimi;
- Shkelje e nenit 6 të LPP-së, Ekonomiciteti dhe Efekistatitit;
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;

Sa i përket Direktivave të BE-së, parimi theksohet si në vijim:

"Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik".

- Efikasiteti &Efektiviteti, duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për AK.
- Drejtësia/Mos diskriminimi, të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të pa nevojshme ose pengesa për furnizuesit ose furnizuesit potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
- Transparenca, të sigurohen kushte dhe qasje të barabarte për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.
- Llogaridhënie, të ketë llogaridhënie për përgjegjësit e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Në dosjen e tenderit dhe në FTD është kërkuar:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

9.2. 1. Operatori ekonomik duhet të prezantoj 1 (një) referencë për punë të ngjashme në objektin industrial në tri vitet e fundit nga ku shihet përvoja e punës.

Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale

9.1. 1. Projektet e realizuara brenda 3 viteve të fundit.

Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar më arsyetim se na mungojnë:

1. Makineria për pastrim të kanalizimeve (pjesët përcjellëse-material shpenzues)
2. Referencat e punëve të ngjashme.

Posedojmë makinerinë speciale për pastrimin e kanalizimeve dhe tërheqjen e ujërave të zeza. Kemi dorëzuar:

- Certifikatat e regjistrimit të automjeteve:
- Ndërtimi: Kamion për pastrimin e kanalizimeve
- Deklaratën e vërtetuar për kryerjen e shërbimeve të kërkuara

Të nderuar në dosjen e tenderit është kërkuar:

- Referencë e punëve të ngjashme
- Kemi dorëzuar 4 (katër) referenca të punëve të ngjashme:
  1. Referenca e Industrisë së Mishit
  2. Fabrikës së Birrës
  3. Fabrikës së Djathit
  4. KFOR-CENTRO AMMINISTRIVO D'INTENDENZA VILLAGGIO ITALIA-BELO POLJE-DECAN KOSOVO

Te nderuar

Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar LPP, ka vepruar njëanshme edhe pse konzorcimi "ER LIS& VE MOR" i ka përmbushur të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit dhe në FDT e po ashtu edhe kushtin kryesor: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Dëshmitë e dorëzuar:

- Certifikatat e regjistrimit të automjeteve;
- Ndërtimi: Kamion për pastrimin e kanalizimeve;
- Deklaratën e vërtetuar për kryerjen e shërbimeve të kërkuara;
- Referencat;

Propozim

OSHP-së i propozojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga "ER LIS SH.P.K. & VE-MOR SH.P.K." për aktivitetin e prokurimit KEKO-16-145-221, me titull: "Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave gypave të kracerit", të nxjerrë:

VENDIM

I. APROVOJË, si të bazuar ankesën e OE "ER LIS SH.P.K. & VE-MOR SH.P.K." Pejë

II. ANULOJ, vendimin për tenderuesin e eliminuar dhe dhënie të kontratës

III. URDHËROHET, AK-së, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) që aktivitetin e prokurimit KEKO-16-145-221, me titull: "Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave gypave të kracerit", ta kthej ne Ri-Vlerësim dhe të shpall fitues kompaninë tonë, pasi që i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit e po ashtu edhe kushtin kryesor Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Procesi i prokurimit

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues(N.22.1).....15.02.2016

Data e njoftimit për kontratë (N. 40) 29.11.2016

Lloji i procedurës së aplikuar (N.33-38):-.....Procedura e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16): .....Shërbime /e mesme

Vlera e përllogaritur për këtë prokurim (N.15-19): ..... 35,000.00 €

Data dhe vlera e akordimit të mjeteve financiare nga AK (N.9): .....

Afati kohor për pranimin e projekteve (gjithsejtë ditë): 22.12.2016

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60): ..... Tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më i ulët.

Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri (N.65-69):

1. Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 65.
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.
3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" Pika III. 1.1.) 2. a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.

Dëshmitë dokumentare:

1. Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. - Origjinal

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise, pika 2, dhe 3 do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

Kërkesat përshtatshmërisë profesional (N. 66):

a. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
b. Regjistrimi në TVSH; dhe
c. Regjistrimi i Numrit Fiskal.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend /Kopja e certifikatës së biznesit);
2. Kopja e certifikatës TVSH-se;
   Kopja e certifikatës numrit fiskal

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 68 të LPP-së)

- Sigurimi i tenderit 1000,00€
- Sigurimi i ekzekutimit 10%, vlerës së kontratës

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

/

Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (neni 69 të LPP-së)

1. Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Operatori Ekonomik duhet te prezantoje 1(një) reference për pune të ngjashme në objektet industriale në tri vitet e fundit nga ku mund të shihet provoja e punës.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N. 58):

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	"VETONI"	Rahovec	25,999.92€
2.	"ER-LIS&VE-MOR SH.P.K."	Pejë	26,904.00€
3.	"MEGI BAU Gmbh"	Rahovec	25,000.00€
4.	"KASTRATI-L"	Gllogoc	77,292.00€

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 3 (tre) OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik dhe çmimi.

Komisionet vlerësues pran AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N. 59).

Autoriteti kontraktues, me dt. 04 janar 2017, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve, si në vijim:

- Mehdi Muqolli, Përfaqësues nga TC Kosova B- Kryetar
- Ahmet Islami, Përfaqësues nga TC Kosova B, Anëtar
- Hasan Maxhuni, Përfaqësues nga Zyra e Prokurimit -Anëtar

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimi:..... 26.01.2017

Data e njoftimit për dhënie të kontratës (N. 41):.....21.02.2017

Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE (N. 108/A):.....01.03.2017

Raporti i komisionit vlerësues

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues konstatoj se prej 4 (katër) operatorëve ekonomik që kanë ofertuar, ne aktivitetin e prokurimit **"Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave të kracerit"**, me nr. të prokurimit KEKO/16/145/221, 1 (një) operator ekonomik i plotëson kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa 3 (tre) operator ekonomik janë të papërgjegjshëm pasi që nuk kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

- OE "VETONI" Rahovec, në ofertë nuk ka prezantuar referenca të mjaftueshme, pasi që në listën e referencave nuk ka dëshmuar se ka bërë pastrimin e kanalizimeve teknologjike në industri dhe gjithashtu nuk ka dëshmuar se ka bërë pastrime të kapaciteteve të njëjta me ato të kërkuara në dosjen e tenderit.

- OE "ER-LIS&VE-MOR SH.P.K." Pejë, në ofertë nuk ka prezantuar referenca dhe foto të automjeteve dhe të disa dizave. Referencat e ofruar nga kompania e "Birrarisë" Pejës, kompani "Buçuku", Hotel "Magra", Ujë "Rugova" dhe Itali KFOR-i nuk dëshmojnë, ngjashmërinë e materialeve rrjedhëse me ato të cilat rrjedhin në kanalizimet industriale me afinitet lidhës (cementues –betonues) siç është rasti i kanalizimeve të gypave të kracerit në objektin-objektet termoenergjetike siç është objekti, në këtë rast parashtruesi i kërkesës TC/B-ja. Deklarativisht janë potencuar dizat (rotative, rotative me zinxhir, iriqet dhe pajisjet tjera speciale), këto të dhëna të deklaruara nuk janë dëshmuar me foto dhe dokumentacionin e kërkuar sipas parashtruesit të kërkesës, që do të dëshmonte se OE me herët ka kryer punë, në kanalizime të objekteve industriale të ngjashme. Dokumentacion i ofruar nuk është i mjaftueshëm, Konzorciumi nuk ka dëshmi operuese që dëshmojnë ngjashmërinë e materialeve rrjedhëse të kanalizimeve në të cilat ka operuar dhe se materialet rrjedhëse të atyre objekteve u ngjasojnë materialeve rrjedhëse të objektit të TC/B-së.

- OE "MEGI BAU Gmbh" Rahovec, në ofertë nuk ka prezantuar referenca të mjaftueshme, pasi që në listën e referencave nuk ka dëshmuar se ka bërë pastrimin e kanalizimeve teknologjike në industri dhe gjithashtu nuk ka dëshmuar se ka bërë pastrime të kapaciteteve të njëjta apo të përafërta me ato të kërkuara në dosjen e tenderit.

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimi të ofertave konkurruese ka ardhur ne përfundim se oferta e ofertuesit "KASTRATI-L" nga Gllogoci, i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe si e tillë është oferta me çmimin me të lirë për këtë tender 77, 292.00€.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës Tenderime, është konstatuar, si në vijim:

Sqarimi: Nr. 1 (mbarëvajtja e procedurës së prokurimit).

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit**"Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave të kracerit"**, me nr. të prokurimit KEKO/16/145/221, ka aplikuar procedurën hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike kornizë 24 muaj, shërbime, vlerë e mesme. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sqarimi: Nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet: Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar më arsyetim se na mungojnë: Referencat e punëve të ngjashme, ekspertja shqyrtues bazuar ne shkresat e lëndës sqaron se autoriteti kontraktues ne FTD- Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ka kërkuara: *Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit.* Dëshmia dokumentare: *Operatori Ekonomik duhet te prezantoje 1(një) reference për pune të ngjashme në objektet industriale në tri vitet e fundit nga ku mund të shihet provoja e punës.*

Ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues konform kërkesës së lartë cekur si dëshmi ka ofruar: Referencën e lëshuar nga "BUQUKU"sh.p.k. Pejë për OE "VE-MOR" , ku ndër të tjerë thuhet: *jemi duke e realizuar kontratën: Ofrimi i shërbimeve të zbrazjes së Depozitave të ujërave të zeza dhe depertimin dhe pastrimin e gypave ne industrinë e mishit "BUQUK".*

Referencë: BIRRA"PEJA" për OE "VE-MOR" sh.p.k., ku thuhet: *me sukses ka kryer pastrimin dhe hapjen e kanalizimeve në kompleksin e Fabrikës së Birrës ku janë edhe Fabrika e Maltit, Fabrika e Alkoolit të rafineruar dhe rrjetit tregtarë.*

Sqarimi: Nr. 3

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenin 59 të LPP-së, respektivisht ku ndër të tjera thuhet: *"Posedojmë makinerinë speciale për pastrimin e kanalizimeve dhe tërheqjen e ujërave të zeza"*, ekspertja shqyrtuese sqaron se autoriteti kontraktues në Ankesin 1 te specifikimet teknike të detyrueshme te obligimet e operatorit ekonomik në pikën 2 (dy) ka specifikuar: *Autocisternë me shtypje deri ne 250 bar, duhet të posedoj mjetet përcjellëse për kryerjen e punëve për këtë shërbim siç janë: diznet rotative dhe me zinxhir, iriqëve nga metali për thyrejn e hirit të betonit ne gypat e kanalizimit teknologjik dhe pajisjet për tërheqjen e mbeturinave që mbeten ne gypa përcjellës të kanaleve të ujit teknologjik, duhet të posedoj gyp në gjatësi më së paku 100m dhe lloje të ndryshme te dizve për depërtimin e kanalizimeve si dhe ndonjë pajisje tjetër speciale për depërtimin e gypave të shtresuar nga hiri që është ngurtësuar në brendësi të*

gypave nëse operatori ekonomik i disponon ti ofroi me ofertë.

Ndërsa operatoret ekonomik janë të obliguar te paraqesin në ofertë: Dokumentacion teknik (për pajisje) te cisternave me pjesë përcjellëse për depërtim të kanalizimeve katalog ose fotografi të pajisjeve.

Ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues lidhur me kërkesën e lartë cekur ne specifikim teknike si dëshmi ka ofruar: Deklaratë se pajtohet me specifikimin teknik, makineria, Certifikatën e regjistrimit të automjetit me përshkrim "Kamion për pastrimin e kanalizimeve dhe larjen të rrugëve" , si dhe Certifikatën e regjistrimit të automjetit me përshkrim "Kamion për pastrimin e kanalizimeve", bashkangjitur fotografi të pajisjeve.

Ekspertja shqyrtues në mbështetje të asaj që u tha më lartë si dhe ne mbështetje te nenit 1 dhe 6 te LPP-se, propozon që aktivitet prokurimit të kthehet ne rivlerësim, sipas nenit 72 te LPP-se, me qëllim të verifikimit - sqarimit të dëshmive të ofruara nga parashtruesi i ankesës, nëse te njëjtat si te tilla e plotësojnë kërkesën lartë cekur të e AK-se.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e **"Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave gypave të kracerit"**, me nr. të prokurimit KEKO/16/145/221, si dhe bazuar ne sqarimin nr. 3, i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa autoriteti kontraktues të anuloj vendimin njoftim për dhënie të kontratës, të dt. 21 shkurt 2017, dhe lëndën ta kthej ne Rivlerësim.